

English below

**DEKLARATA E BEOGRADIT MBI ZHVILLIMIN E SIPËRMARRJES SOCIALE NË RAJONIN E
BALLKANIT PERËNDIMOR DHE TURQISË**

Me dëshirën për të kontribuar për zhvillimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, i cili përballet me probleme serioze sociale dhe ekonomike (si varfëria, pabarazia, papunësia, përjashtimi social, etj), nëpërmjet Deklaratës së Beogradit për Zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale ne dëshirojmë të theksojmë për vendim-marrësit si në BE ashtu edhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, hapat e nevojshëm për t'u ndërmarrë, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë sociale si një model i përshtatshëm për zhvillimin e qëndrueshëm social të të gjithë rajonit.

Ndërmarrjet sociale vijnë në mënyra dhe madhësi të ndryshme, e forma të ndryshme ligjore në të gjithë Evropën. Siç u tha në Nismën e Komisionit Evropian për Biznesin Social, ato kanë karakteristikat e përbashkëta të mëposhtme:

- Gjenerimin e të ardhurave nga aktiviteti tregtar
- Kanë si objektiv social apo shoqëror të mirën e përbashkët si arsye për aktivitetin e tyre ekonomik, shpesh në formën e një niveli të lartë të inovacionit social
- Fitimet ri-investohen kryesisht me synimin për arritjen e këtij objektivi social
- Kanë një metodë organizimi apo sistemi pronësie që reflekton misionin e tyre, duke përdorur qeverisjen demokratike apo parimet e pjesëmarrjes, ose duke u fokusuar në drejtësinë sociale.

Si organizata të shoqërisë civile që në mënyrë aktive promovojmë dhe mbështesim procesin e anëtarësimit të rajonit në BE, ne besojmë thellësisht në parimet e miratuara në kuadër të Deklaratës së Strasburgut, e cila përcakton prioritetet dhe rekomandimet për veprime në emër të BE-së dhe Parlamentit Evropian, parime të cilat synojnë zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjes sociale. Ne besojmë se Deklarata e Strasburgut duhet të përfaqësojë një pikë fillimi për politikat kyçe kombëtare në fushën e zhvillimit të sipërmarrjes sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Ne besojmë thellësisht se rajoni ynë kërkon një model të ri zhvillimi ekonomik dhe social, një sistem që do të jetë më i drejtë, më përfshirës dhe më i qëndrueshëm. Të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë qytetare, jemi mbledhur së bashku në vendet tona, si dhe jemi lidhur në nivel rajonal për të miratuar Deklaratën e Beogradit mbi Zhvillimin e Sipërmarrjes Sociale në Rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, me qëllim për të ftuar institucionet e Bashkimit Evropian si dhe institucionet e tjera në vendet e

Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për të marrë përgjegjësinë dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e sipërmarrjes sociale.

Ne dëshirojmë të ndikojmë në Bashkimin Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për t'u angazhuar më fuqishëm, në të gjitha nivelet, për krijimin e masave, politikave dhe instrumenteve financiare që do të mbështesin ndërtimin e një eko-sistemi të favorshëm për zhvillimin e ekonomisë sociale në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Si partnerë relevantë, ne duam të ndihmojmë vendimmarrësit në BE, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Malin e Zi, Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Turqi për të zbatuar objektivat e mëposhtëm që do të kontribuojnë në zhvillimin e sipërmarrjes sociale:

- Bashkimi Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia duhet të sigurojnë se angazhimi i tyre për të krijuar një eko-sistem të favorshëm për zhvillimin e sipërmarrjes sociale është i inkorporuar në politikat e tyre. Duhet të ketë një angazhim më të fortë në BE, nivel kombëtar, rajonal dhe lokal në partneritet me sektorin e ndërmarrjeve sociale në bashkë-krijimin e politikave të reja për të mbështetur sipërmarrjen sociale, të përshtatura për kontekstin lokal.
- Është e nevojshme që vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia të përcaktojnë dhe miratojnë në partneritet me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë kyç, një set udhëzimesh të qarta dhe të realizueshme të veprimeve për zhvillimin e ekonomisë sociale, të koordinuara me politikat e BE-së në këtë fushë.
- Është e nevojshme nxitja e partneriteteve ndërmjet shteteve, autoriteteve rajonale dhe lokale, organizatave të shoqërisë civile, bizneseve, subjekteve ekonomike dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në fushën e sipërmarrjes sociale. Është gjithashtu i nevojshëm forcimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve sociale dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm që kanë një rol në zhvillimin e sipërmarrjes sociale, si dhe nxitja e shkëmbimit të informacionit dhe njohurive.
- Në partneritet me sektorin e ndërmarrjeve sociale, shtetet si dhe autoritetet rajonale dhe lokale, duhet të mbështesin plotësisht rritjen e ndërmarrjeve sociale, të ndihmojnë ato të ndërtojnë kapacitetet dhe të mundësojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe njohurive. Për shembull, përmes krijimit të eko-sistemit të favorshëm, qasjen në financa, mbështetjen në fillimin e biznesit, trajnimeve dhe edukimit, dhe lehtësimin e preferencës në prokurimet publike.
- Është e nevojshme që BE-ja të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet sociale në të gjithë rajonin përmes fondeve të ndryshme dhe masave të tjera financiare, veçanërisht në kuadër të fondeve të IPA-s, duke mos e kufizuar mbështetjen e saj për fondet strukturore të arritshme vetëm

për vendet anëtare të BE. Procesi i pranimit në BE paraqet një mundësi të rëndësishme për të promovuar dhe zhvilluar sipërmarrjen sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.

INITIATED BY



KorSP
KORALICIJA ZA RAZVOJ
SOCIJALNOG PREDUZETNIŠTVA



**smart
KOLEKTIV**

SeConS
development initiative group

IEC
INITIATIVE FOR
COOPERATION &
COOPERATION

TÜSEV
Türkiye Üçüncü Sektör Vakfı
Third Sector Foundation of Turkey

FIQ Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives

**Center for
INSTITUTIONAL
DEVELOPMENT - CIRa**
www.cira.org.mk



Fund for Active Citizenship

**FONDACIJA
Mozaik**

**Partners Albania
Center for Change
and Conflict Management**

SUPPORTED BY



Technical Assistance for
Civil Society Organisations
Serbia Office



The project is implemented
by the Swedish Institute for
Public Administration



This project is funded
by the European Union

BELGRADE DECLARATION ON THE DEVELOPMENT OF SOCIAL ENTREPRENEURSHIP IN THE REGION OF THE WESTERN BALKANS AND TURKEY

With a wish to make a contribution to the development of the region of the Western Balkans and Turkey, which faces serious social and economic problems (poverty, inequality, unemployment, social exclusion, etc), through the BELGRADE DECLARATION ON THE DEVELOPMENT OF SOCIAL ENTREPRENEURSHIP we want to point out to the decision-makers both in the EU and the countries of the Western Balkans and Turkey the necessary steps to take which will contribute to the development of social economy as a relevant model for the socially sustainable development of the entire region.

Social enterprises come in many shapes and sizes and take different legal forms across Europe. As stated in the European Commission's Social Business Initiative (SBI), they have the following common characteristics:

- Earning income by trading,
- Having a social or societal objective of the common good as the reason for their economic activity, often in the form of a high level of social innovation,
- Profits being mainly reinvested with a view to achieving this social objective,
- A method of organization or ownership system reflecting their mission, using democratic governance or participatory principles or focusing on social justice.

As civil society organizations that actively promote and support the regional EU accession process, we deeply believe in the principles adopted within the Strasbourg Declaration, defining the priorities and recommendations for the actions on behalf of the EU and the European Parliament aimed at the further development of social entrepreneurship. We believe that the Strasbourg Declaration should represent a starting point for the key national policies in the area of social entrepreneurship development in the countries of the Western Balkans and Turkey.

We deeply believe that our region requires a new model of economic and social development, one that would be more just, more inclusive and more sustainable. Being aware of our civil responsibility, we have come together in our countries as well as connected ourselves regionally by adopting the BELGRADE DECLARATION ON THE DEVELOPMENT OF SOCIAL ENTREPRENEURSHIP IN THE REGION OF THE WESTERN BALKANS AND TURKEY, in order to invite the institutions of the European Union as well as the institutions in the countries of the Western Balkans and Turkey to take responsibility and actively engage in the development of social entrepreneurship.

We wish to influence the European Union, the Western Balkans countries and Turkey to engage more forcefully, at all levels, in the creation of measures, policies and financial instruments that will support the making of a favorable eco-system for the development of social economy across the region of the Western Balkans and Turkey.

As relevant partners, we want to help the decision-makers in the EU, Albania, Bosnia and Herzegovina, Montenegro, Kosovo, Macedonia, Serbia and Turkey to implement the following goals that will contribute to the development of social entrepreneurship:

- The European Union, the Western Balkans countries and Turkey should ensure that their commitment to create a favorable eco-system for the development of social entrepreneurship is mainstreamed in their policies. There must be a stronger engagement at the EU, national, regional and local levels in partnership with the social enterprise sector in

the co-creation of new policies to support social entrepreneurship, suited to the local context.

- It is necessary for the Western Balkans countries and Turkey to define and adopt in partnership with the civil society organizations and other key players sets of clear and feasible action guidelines for the development of social economy, coordinated with the EU policies in this area.
- It is necessary to stimulate partnerships between states, regional and local authorities, civil society organizations, businesses, economic entities and other key players in the area of social entrepreneurship. It is also necessary to strengthen the capacities of social enterprises and other key players that have a role in the development of social entrepreneurship, as well as to stimulate the exchange of information and knowledge.
- In partnership with the social enterprise sector, the states, as well as regional and local authorities, must fully support the growth of social enterprises, help them build capacities and enable cooperation and exchange of information and knowledge. For example, through the creation of favorable eco-system, access to finance, business start-up and development support, training and education, and facilitating preference in public procurements.
- It is necessary that the EU provide financial support to social enterprises across the region through different funds and other financial measures, particularly within the IPA funds, thereby not limiting its support to the structural funds accessible only to the EU member states. The EU accession process represents an important opportunity to promote and develop social entrepreneurship in the Western Balkans countries and Turkey.

INITIATED BY



SUPPORTED BY

